

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 440, datë 11.9.2019

PËR PËRCAKTIMIN E SHËRBIMEVE TË OFRUARA ME ÇMIME TË REDUKTUARA PËRMES PËRDORIMIT TË KARTËS SË STUDENTIT NË FUSHËN E TURIZMIT DHE MJEDISIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe pikës 2, të vendimit nr. 226, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetëror edhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”,

URDHËROJMË:

1. Miratimin e shërbimit me tarifë zero për hyrjen e studentëve, në zonat e përcaktuara sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Efektet financiare nga reduktimi i çmimeve përballohen nga buxheti i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I TURIZMIT
DHE MJEDISIT
Blendi Klosi**

**MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini**

Lidhja nr.1

1. Shërbimi i hyrjes me tarifë zero për hyrjen e studentëve në zonat si më poshtë:

- a) Parku Kombëtar Mali i Dajtit (hyrja me postbllok);
- b) Monumenti Natyror Syri i Kaltër;
- c) Parku natyror Kune–Vain–Tale.